Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY
Nr/Br. 300/19
Datë/Datum 17.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 300/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Nuhi Paçarizi – Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.N.P."Arhiko.ing" – Prishtinë, (ankesa është parashtruar për Lot I dhe II), kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit te prokurimit, me titull: "Studimi i Fizibilitetit të sektorit të Sterilizimit dhe Hemodijalizes pran SHSKUK-së me numër të prokurimit: 00220-19-1974-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës /SHSKUK/, më datën 04.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.N.P."Arhiko.ing" – Prishtinë, (ankesa është parashtruar për Lot I dhe II), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Studimi i Fizibilitetit të sektorit të Sterilizimit dhe Hemodijalizes pran SHSKUK-së, me numër të prokurimit: 00220-19-1974-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës /SHSKUK/.

II. <u>VËRTETOHET,</u> njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: ''Studimi i Fizibilitetit të sektorit të Sterilizimit dhe Hemodijalizes pran SHSKUK-së", me numër të prokurimit: 00220-19-1974-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës /SHSKUK/, ndërsa nëse edhe me tutje AK-ja, ka interes për të vazhduar me ketë aktivitet të prokurimit të njëjtin mund ta ritenderoj konform dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.N.P."Arhiko.ing" – Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë është bërë me dt: 10.04.2019
Hapja e ofertave është bërë me dt: 07.05.2019
Njoftimi me letër standarde për tenderues të eliminuar/pasuksesshëm është bërë dt: 28.05.2019
Njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulim te AP është bërë dt: 28.05.2019
Kërkesë për rishqyrtim është bërë dt: 29.05.2019
Autoriteti Kontraktues me datën 31.05.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues N.N.P."Arhiko.ing" – Prishtinë, (ankesa është parashtruar për Lot I dhe II), si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 10.06.2019 me nr. 300/19, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Studimi i Fizibilitetit të sektorit të Sterilizimit dhe Hemodijalizes pran SHSKUK-së " Lot 1 dhe 2, me numër të prokurimit: 00220-19-1974-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës /SHSKUK/, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 65, 69, dhe 76 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.06.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 20.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: Pretendimi i vetëm ankimor i operatorit ankues, se ne ju kemi referuar FDT-së, aty nuk keni kërkuar që konsulenti të ketë licencë dhe ju nuk e keni cekur kosulenti i cilës fushë duhet të jetë. Ne kemi ofruar 4 inxhinier te fushave te ndryshme përfshirë edhe Znj. Luljeta Ajdini, e cila është e certifikuar për Vlerësime në Mjedis dhe posedon licencën por ju nuk e keni kërkuar ne FTD dhe nuk është e nevojshme nëse nuk ceket ne FTD.
Kompania jonë i ka plotësuar te gjitha kushtet e parashikuara ne dosjen e tenderit mirëpo AK nuk i ka marrë parasysh dokumentet tona duke bere shkelje ligjore. Ne si kompani kemi ofruar eksperiencën tone ne projektim, ku ne kuadër të këtyre kontratave kemi realizuar **shumë studime fizibiliteti**. Po ashtu kemi pasur edhe kontrate te veçante vetëm për fizibilitet te cilën e kemi përfunduar me shume sukses, ashtu siç mund te shihet ne doktunentacion, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është fakt që nuk ka kërkuar që konsulenti duhet të jetë i licencuar. Mirëpo është edhe fakti tjetër që gjatë kohës së marrjes së dosjes së tenderit, para hapjes së ofertave ka pasur pyetje sqaruese për këtë çështje nga një operator ekonomik dhe përgjigjja nga autoriteti kontraktues ka qenë që:

"po eksperti duhet të jetë i licencuar pranë ministrisë së ambientit për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis".

Në momentin kur ky sqarim është ngarkuar në platformën elektronike, atëherë është i **obligueshëm** për të gjithë ofertuesit që të respektohet si kriter i përzgjedhjes në dosjen e tenderit. Megjithatë për këtë pikë të këtij pretendimi ankimor, OE ankues me ankesë ka ofruar një Licencë të znj. Luljeta Ajdini që është e licencuar prej Ministrisë së Ambientit. Luljeta Ajdini është e paraqitur edhe në listën e stafit të OE ankues.

Sa i përket pjesës tjetër të këtij pretendim ankimor se OE ankues si kompani ka realizuar shumë studime fizibiliteti, kjo **nuk qëndron**. Kërkesa e autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit ka qenë:

*"OE (konsulenti) duhet të ketë përvojë të **mjaftueshme** në studime fizibliteti në institucione publike të ngjashme, së paku në 5 vitet e fundit"*

Sipas kësaj kërkese *"përvojë të **mjaftueshme"*** i bije që OE duhet të ketë më shumë se një projekt sepse është fjala për 5 vite, kurse OE ankues në listën e projekteve të dorëzuar me ofertë ka vetëm një projekt të realizuar për studime të fizibilitetit, e ai projekt është:
"Studimi i fizibilitetit për zonën ekonomike në Malishevë" vlera e këtij projekti është 8.999,99 €.

Edhe ky projekt i kryer nga OE ankues, shihet se **nuk është i natyrës së ngjashme** me projektin e autoritetit kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit, që është kërkesë e dosjes së tenderit.
Për mendimin e eksperti shqyrtues, OE ankues **nuk e ka plotësuar** këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Prandaj si i tillë në përgjithësi ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nga AK është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së.OE ankues nuk i ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes për të u kualifikuar si ofertues i përgjegjshëm. Nuk ka projekte të mjaftueshme të realizuara të natyrës së ngjashme me projektin e autoritetit kontraktues. Prandaj me të drejtë është eliminuar si tenderues i pa përgjegjshëm nga AK. Nuk ka shkelje të neneve të LPP-së të përmendura në ankesë.

Në bazë të sqarimit të dhënë më lartë lidhur me përgjigjeje në pretendimin ankimor të OE ankues, eksperti shqyrtues e **Refuzon** ankesën si të pa bazuar.
Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues ta mbajë në fuçi vendimin për **anulim** për aktivitetin e prokurimit **"Studimi i Fizibilitetit të sektorit të Sterilizimit dhe Hemodijalizes pranë SHSKUK-së" me nr. prokurimi 00220-19-1974-221** dhe nëse shpreh interesim më tutje për këtë aktivitet të prokurimit ta Ritenderoj atë.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 21.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 21.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, eksperti profesional i prokurimit, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertes shqyrtuese, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Sylaj deklaroj: Një OE ka bërë pyetje sqaruese për piken 1 dhe 2, ku nuk është cekur mënyra e dorëzimit te tenderit a mundemi të dorëzojmë ne mënyrë e-elektronike dhe Autoriteti Kontraktues ju ka përgjigjur ka thënë se te gjitha dosjet duhen të dorëzohen ne mënyrë elektronike. Pika 2, Lot 1 pika 1 dhe pika 3 Përshkrimi i situacionit aktual vlerësimi apo hapësirave te zhvillimit për ofrimin e shërbimeve për sterilizimin e pajisjeve kirurgjike dhe sallave te operacionit, Pika 3. Përshkrimin e përgjithshëm te projektit për ofrimin e instrumenteve kirurgjikale për QKUK dhe spitalet rajonale.
Ne FTD nuk është kërkuar asnjë inxhinier vetëm kriteri ka qenë qe OE duhet ti ketë përvojë të mjaftueshme të ngjashme ne 5 vitet e fundit, ne e kemi plotësuar këtë kriter dhe kemi dorëzuar kontrate dhe ne kemi inxhinierin znj. Luljeta Hajdini. Sipas ligjit 04/L-159 për zonat ekonomike.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Krasniqi deklarojë: Autoriteti Kontraktues ka shpallur tender publik për studimin e fizibilitetit te sektorit Sterilizimit dhe Hemodializes gjate procedurës një OE ka bërë dy (2) pyetje se a duhet te dorëzohet tenderi ne mënyrë elektronike dhe ne e kemi cek se duhet të dorëzohen ne mënyrë elektronike si dhe ka pyetur për specifikacionet teknike të detyrueshme te FDT-së, te cekur vendimi social mjedisor pyetja është a duhet eksperti te jetë i licencuar pran MMPH-së, si person fizik për hartimin e raporteve te vlerësimit te ndikimit te mjedisit? Dhe Përgjigja jone ka qene PO duhet te jete i Licencuar sipas ligjit ne fuqi. Dhe ne këtë rast ky behet kriter. Pas hapjes Autoriteti Kontraktues ka caktuar komision profesional vlerësues prej tyre 2 inxhinier dhe kanë bere ekzaminimin profesional me te cilën kanë vërtetuar se asnjeri prej OE-ve nuk i plotëson kushtet për te shpallur fitues te këtij AP. Ne kemi marr vendim te anulojmë këtë AP.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti profesional i prokurimit z. Kurtishaj deklaroj: Arsyeja bazike e OE qe është eliminuar ka qenë qe nuk e ka plotësuar një kërkesë të DT qe ka qenë qe : OE (Konsulenti duhet te ketë përvojë te mjaftueshme ne institucione te ngjashme se paku 5 vite pune). OE ankues ne listën qe e ka bashkangjitur ne platformë aty është një projekt për studime fizibiliteti ne zonën ekonomike Malishevë. Edhe për nga natyra ky nuk është i ngjashëm, prandaj për mendimin tim kjo kërkesë nuk është

plotësuar nga OE ankues dhe me te drejt Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Sylaj deklaroj: Kërkojmë të aprovohet si e bazuar ankesa jonë dhe lënda të kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Krasniqi deklaroj: Propozojmë të refuzohet ankesa e OE si e pabazuar dhe të mbetet ne fuqi vendimi i AK-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues N.N.P."Arhiko.ing" – Prishtinë, pretendon se ju është referuar FDT-së, dhe aty nuk është kërkuar që konsulenti të ketë licencë dhe nuk është cekur që kosulenti i cilës fushë duhet të jetë. OE ankues ka ofruar katër (4) inxhinier te fushave te ndryshme përfshirë edhe Znj. Luljeta Ajdini, e cila është e certifikuar për Vlerësime në Mjedis dhe posedon licencën por AK nuk e ka kërkuar ne FTD, dhe nuk është e nevojshme nëse nuk ceket ne FTD.

OE ankues N.N.P."Arhiko.ing" – Prishtinë, pretendon se i ka plotësuar te gjitha kushtet e parashikuara ne dosjen e tenderit mirëpo autoriteti kontraktues /SHSKUK/, nuk i ka marrë parasysh dokumentet e OE në fjalë ku pretendon bere shkelje ligjore. OE në fjalë, pretendon se ka ofruar eksperiencën ne projektim, ku ne kuadër të këtyre kontratave ka realizuar shumë studime fizibiliteti. Po ashtu ka pasur edhe kontrate te veçante vetëm për fizibilitet për të cilat e pretendon se i ka përfunduar me shume sukses, ashtu siç mund te shihet ne dokumentacion .

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se Autoriteti kontraktues//SHSKUK/, në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është fakt që nuk ka kërkuar që konsulenti duhet të jetë i licencuar. Mirëpo është edhe fakti tjetër që gjatë kohës së marrjes së dosjes së tenderit, para hapjes së ofertave ka pasur pyetje sqaruese për këtë çështje nga një operator ekonomik dhe përgjigjja nga autoriteti kontraktues ka qenë si në vijim:

"po eksperti duhet të jetë i licencuar pranë ministrisë së ambientit për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis".

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se në momentin kur ky sqarim është ngarkuar në platformën elektronike, atëherë është i obligueshëm për të gjithë ofertuesit që të respektohet si kriter i përzgjedhjes në dosjen e tenderit. Megjithatë për këtë pikë të këtij pretendimi ankimor, OE ankues me ankesë ka ofruar një Licencë të znj. Luljeta Ajdini, që është e licencuar prej Ministrisë së Ambientit, ku zonja Luljeta Ajdini, është e paraqitur edhe në listën e stafit të OE ankues, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të këtij pretendimi ankimor se OE ankues si kompani ka realizuar shumë studime fizibiliteti, kjo nuk qëndron. Kërkesa e autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit ka qenë si në vijim :

"OE (konsulenti) duhet të ketë përvojë të mjaftueshme në studime fizibliteti në institucione publike të ngjashme, së paku në 5 vitet e fundit"

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se sipas kësaj kërkese *"përvojë të mjaftueshme"* i bije që OE duhet të ketë më shumë se një projekt sepse është fjala për pesë (5) vite, kurse OE ankues në listën e projekteve të dorëzuar me ofertë ka vetëm një projekt të realizuar për studime të fizibilitetit, e ai projekt është: *"Studimi i fizibilitetit për zonën ekonomike në Malishevë"* vlera e këtij projekti është 8.999,99 €.

Ku ky projekt i kryer nga OE ankues, shihet se nuk është i natyrës së ngjashme me projektin e autoritetit kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit, që është kërkesë e dosjes së tenderit.

Andaj, OE ankues N.N.P."Arhiko.ing" – Prishtinë, nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit dhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nga autoriteti kontraktues /SHSKUK/, është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së, ku OE ankues nuk i ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes për të u kualifikuar si ofertues i përgjegjshëm. Nuk ka projekte të mjaftueshme të realizuara të natyrës së ngjashme me projektin e autoritetit kontraktues. Prandaj me të drejtë është eliminuar si tenderues i pa përgjegjshëm nga ana e AK.

Paneli shqyrtues duke u nisur nga të dhënat si me lart vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit te prokurimit në fjalë është bëre në harmoni me nenin 62 të LPP-së, për faktin se asnjë nga ofertat e operatorve ekonomik pjesëmarrës ne ketë aktivitet te prokurimit nuk plotësojnë kriteret ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – SHSKUK - Prishtinë,

1x1 OE – N.N.P."Arhiko.ing" – Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.